




REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS

Thirrje për Projekte. Ekspozita XVI Ndërkombëtare e Arkitekturës - Bienale e Venecias 2018

2017-08-02 14:44:00



Ministria e Kulturës do të marrë pjesë në Ekspozitën e XVI-të Ndërkombëtare të Arkitekturës - Bienale e Venecias 2018, me temë : “Freespace” - që do të zhvillohet nga 26 maji deri më 25 nëntor 2018 në Arsenale dhe Giardini në Venecia, Itali . Tema e kësaj Bienaleje “Freespace” është përzgjedhur nga Kuratorët e edicionit të 16-të, Yvonne Farrel dhe Shelley McNamara, të cilat kanë motivuar zgjedhjen e tyre: Ministria e Kulturës do të marrë pjesë në Ekspozitën e XVI-të Ndërkombëtare të Arkitekturës - Bienale e Venecias 2018, me temë : “Freespace” - që do të zhvillohet nga 26 maji deri më 25 nëntor 2018 në Arsenale dhe Giardini në Venecia, Itali .

Tema e kësaj Bienaleje “Freespace” është përzgjedhur nga Kuratorët e edicionit të 16-të, Yvonne Farrel dhe Shelley McNamara, të cilat kanë motivuar zgjedhjen e tyre:

“Freespace përshkruan bujarinë e shpirtit dhe ndjenjën e humanizmit, në thelbin e agjendës së arkitekturës, duke përqendruar vëmendjen në vetë cilësinë e hapësirës. Freespace përqendrohet në aftësinë e arkitekturës për të ofruar hapësira të lira dhe hapësira shtesë për ata që e përdorin atë, si dhe në aftësinë e saj për të adresuar dëshirat e pashprehura të të huajit. Freespace inkurajon të rishqyrtojmë mënyrën e të menduarit, duke nxitur mënyra të reja të të parit të botës dhe të japë zgjidhje në të cilën arkitektura siguron mirëqenien dhe dinjitetin e çdo banori të këtij planeti të brishtë.

Freespace mund të jetë një vend i mundësive, një hapësirë publike, jo e planifikuar dhe e lirë për përdorime ende të pa përcaktuar. Ajo ç’ka na intereson është të shkojmë përtej asaj që është e dukshme, duke theksuar rolin e arkitekturës në skenën e jetës së përditshme”.

Për më shumë informacion mbi tematikën, vizitoni faqen e Bienales së Venecias 2018, www.labiennale.org.

Në kuadrin e Ekspozitës XVI Ndërkombëtare të Arkitekturës - Bienale e Venecias 2018, Ministria e Kulturës, me cilësinë e komisarit të Pavijonit Shqiptar, shpall thirrjen për paraqitjen e projektit për pavijonin shqiptar, frymëzuar nga një vëzhgim i kujdesshëm i arkitekturës bashkëkohore dhe i shoqërisë shqiptare, sidomos aty ku kjo bën ndryshimin, si dhe mjetet vizuale përmes të cilave ato do t’i komunikohen publikut të gjerë dhe profesionistëve.

PROFILI I KANDIDATËVE

1. Të jenë studio arkitekturore apo ekupe multidisiplinare të cilët kanë në përbërje të tyre arkitekt (drejtuesi), artistë, *grafic designer*, kritikë, etj.
2. Të dëshmojnë njohuri të mira mbi arkitekturën shqiptare.
3. Të kenë përvojë kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e arkitekturës, urbanistikës dhe peizazhit e cila do të dëshmohet përmes portofoleve të punimeve.
4. Mund të jenë shqiptare, apo të huaj.

KANDIDATI DUHET TË JETË I AFTË:

1. Të kryejë studimin dhe të zhvillojë konceptin original të shoqëruar me një rrëfim kuratorial koherent.
2. Të hartojë projektin kuratorial të integruar për Pavijonin Shqiptar së bashku me të gjithë përmbajtjen e ekspozitës, përfshirë këtu fotografi, instalacione, modele dhe material të shkruar për panelet e ekspozitës.
3. Të hartojë programin kulturor që do të shoqërojë pavionin shqiptar përgjatë kohëzgjatjes së Bienales.
4. Të realizojë kurimin, zbatimin dhe menaxhimin e plotë të projektit .

Ministria e Kulturës inkurajon të gjithë kandidatët të bashkëpunojnë me kuratorë vendas dhe/ose të huaj që kanë përvoja respektive në organizime dhe pjesëmarrje në ekspozita të ngjashme.

PËRZGJEDHJA DO TË KALOJË NËPËR DY FAZA:

Faza I: Faza e përzgjedhjes së projekt-ideve më të mira. Kjo fazë është e hapur deri më **3 nëntor 2017 ora 24.00**.

Shpallja e fituesve të Fazës I: Juria do të bëjë përzgjedhjen e 3 projekt-ideve më të mira, që do të kualifikohen për në fazën e dytë të konkursit, brenda datës **10 nëntor 2017**.

Faza II: Faza e paraqitjes së projekteve të plota të Pavijonit Shqiptar mbi projekt-idetë e kualifikuara në fazën e parë. Këto projekte duhet të paraqiten deri me datë **20 dhjetor 2017 ora 24.00**. Juria do të shpallë kërkesat mbi paraqitjen e projektit të plotë menjëherë pas shpalljes së fituesve të fazës së parë.

Shpallja e fituesit: Ekipi fitues do të shpallet brenda datës **22 dhjetor 2017**.

PROCEDURA E PËRZGJEDHJES

Projekt-idetë dhe projektet e plota do të shqyrtohen nga një juri ndërkombëtare me 5 anëtarë. Vlerësimi i Jurisë do të bazohet në kriteret e mëposhtme:

- a. Qartësi në projekt-ide
- b. Forcë e imagjinatës
- c. Zgjidhje kuratoriale për të komunikuar me publikun
- d. Kapacitet i projektit (idesë) për t'u "përkthyer" në një gjuhë dhe peizazh vizual
- e. Reflektim dhe risi në përmbajtje
- f. Kapacitet dhe eksperiencë për të komunikuar arkitekturën tek audiencia, kritiks si dhe për të zhvilluar audiencia të reja.

DOSJA E KANDIDIMIT PËR FAZËN I:

Dosja e kandidatit duhet të përmbajë:

- a. Formularin e kandidimit (shkarkojeni [KËTU](#))
- b. Një sinopsis të artikuluar qartë mbi temën e dhënë (1000 fjale)
- c. Metodën e hulumtimit, gjetjet e parashikuara dhe si do të jetëzohen ato në pavijon.
- d. Imazhe që ilustrojnë vizionin për ekspoziten
- e. Portofoli i punimeve të realizuara nga ekipi dhe/ose anëtarët e tij.
- f. CV-të e pjesëtarëve të ekipit dhe drejtuesit të tij (deri në një faqe secili).

Kandidatët janë të lirë të zgjedhin format dhe mjetet për paraqitjen e idesë së tyre. Ata ftohen të respektojnë udhëzimet e përcaktuara nga Kuratorët e Bienales së 16-të Ndërkombëtare të Arkitekturës në Venecia që i gjeni në faqen e Bienales së Venecias 2018,

TË DHËNA TEKNIKE PËR PAVIJONIN SHQIPTAR:

Pavijoni shqiptar do të vendoset në Arsenale. Planimetria, prerja dhe foto e pavijonit gjenden [KËTU](#).

Dorëzimi i dosjes:

Dosja duhet :

1. të përgatitet në dy gjuhë: shqip dhe anglisht
2. të dërgohet me postë (në formë të printuar dhe digjitale) në vëmendje të Sekretarisë Teknike të Bienales 2018 në adresën : Ministria e Kulturës, Rruga Aleksandër Moisiu, nr 76, ish Kinostudio "Shqipëria e Re" Tiranë
3. të dërgohet elektronikisht në adresën: biennale2018@kultura.gov.al
4. të dërgohet brenda datës **3 nëntor 2017** ora 24.00 (faza I).